



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

Nr: 03-111/01-41687

Datë: 19.08.2026



KOMUNA LIPJAN
OPSTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

**DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE-
SHTËPIA ME BAZË NË KOMUNITET**

Bazuar ne nenin 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarë Publik nr. 08/L-197, neni 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-121, Rregullore (QRK) Nr.30/2024 për Procedurën e Pranimi të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë, neni 49 pika 49.2 të Statutit të Komunës së Lipjanit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale shpall:

K O N K U R S
Për plotësimin e vendeve të punës

Një (1) Infermier/re të përgjithshëm-Shtëpia me bazë në Komunitet

Detyrat dhe përgjegjësitë për Infermier/e i/e përgjithshme

1. Organizimi i punës në njësi
2. Mbikëqyrja e hixhienës në njësi
3. Dhënia e terapisë për rezidentë
4. Pastrim-lidhje të plagëve
5. Mbikëqyrja e shëndetit të rezidentëve
6. Aktivitete me rezidentë
7. Përcellja e dokumentacioneve të rezidentëve
8. Aftësi dhe shkathtësi profesionale
9. Aftësi komunikuese dhe përfaqësuese
10. Punë tjera
11. Për punën e tij-saj duhet të raportoj menagjerin- mbikëqyrësin

Kushtet dhe kriteret për Infermier/e të Përgjithshëm

- Fakulteti Baçelor i Shkencave në Infermieri – Drejtimi i Përgjithshëm.
- Licenca e Punës (me afat)
- Certifikata Shëndetësore (jo ma e vjetër se gjashtë muaj)
- Rezumeja personale (CV)
- Certifikata që nuk është nën hetime nga Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan (jo ma vjetër se gjashtë muaj)
- Vërtetimi nga Policia që nuk është nën hetime (jo ma e vjetër se gjashtë muaj)
- Kopja e Letërnjoftimi (me afat).

Aftësitë:

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të ketë aftësi komunikimi
- Të ketë aftësi për udhëheqjen e punës i pavarur dhe në grupe duke respektuar ligjet si dhe etikën
- Të ketë aftësi në organizimin e punës dhe në kryerjen e detyrave të përshkruara më lartë
- Të ketë gatishmëri të punojë me të gjitha grupet, pa dallim: moshe, gjinie, kulture, etnike apo religjioni.

Paga mujore për Infermier:

Koeficienti: (grupi H klasa H16 koeficienti 6.5)

Kohëzgjatja e kontratës me kohë të pacaktuar

Puna Provuese gjashtë muaj (6)

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi është i hapur 30 ditë kalendarike, e drejta për aplikim nga data 19.08/2026 deri me 17.09/2026 që konsiderohet si dita e fundit e konkurrit.

Paraqitja e Aplikacioneve:

Aplikacionet mundë të merren në mënyrë fizike në zyrën për shërbime me qytetarët në Komunën e Lipjanit sporteli nr. 3 dhe dorëzohen në të njëjtën sportel bashkë me dokumentet e kërkuar në konkurs.

Vërejtje:

Dokumentet e dorëzuara duhen të janë kopje, (të noterizuara Diploma dhe Licenca) dhe ato nuk kthehen, ndërsa aplikacionet e pa kompletuara dhe pas afatit nuk do të shqyrtohen, **te gjitha njoftimet dhe rezultatet shpallen në ueb faqen e Komunës <https://kk.rks-gov.net/Lipjan> dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës.**

